



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 336/12

Nr. i fq. / Br. sht -1-

Data: / Datum 27.12.2012

VUSHTRRI - VUČITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d", nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, si dhe në nenin 5 të Rregullores për rregullimin, sigurimin dhe mirëmbajtjen e varrezave në territorin e Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27.12.2012** mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e interesit të përgjithshëm për vendosjen e varrezave të qytetit

Neni 1

Me këtë vendim caktohet interesi i përgjithshëm në pronën e paluajtshme si vijon: Numri i fletëreguesit 600, numri i parcelës 4182-0 nr. i protokollit 18/4779, Zona Kadastrale Vushtrri, me kulturë arë, klasa 6, pjesë nga parcela në sipërfaqe prej 22.76.28 ha, pronë e Kooperativës Bujqësore në Vushtrri.

Neni 2

Patundshmëria e cekur në nenin 1 të këtij vendimi shërben për përcaktimin e lokacionit për vendosjen e varrezave të qytetit të Vushtrrisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa



DREJTORIA PËR GJEODOZI, KADASTËR DHE PRONË /
DREJTORIASerbian /
DREJTORIAEnglish/

KOPJE PLANI / KOPIJA PLANA / COPY OF PLAN

18/4779

Zona Kadastrale / Katastarska opstina / Cadastral Zone: VUSHTRRI

/ 70202016


Pronari, Shfrytëzuesi / Vlasnik, Korisnik / Owner, Possess.: KOPERATIVA BUJQESORE 1/1

Fletëposedimi nr. / Posedovni list. nr.600

Parcela nr. / Br.plana / Parcel Nr.4181-0,4182-0



P-1:500



ata / Datum / Date: 06.11.2012

E punoi / Uradiotari / Operator:



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPËSTINA VUÇITRN

DI Nr. / Br 335/12

Nr. i Eq. / Br. st -1-

Data: / Datum 27.12.2012

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 12.2 "d", nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 mori këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, aty ku ka participim nga ana e qytetarëve

Neni 1

Me këtë vendim mundësohet vendosja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra aty ku kemi participim nga ana e qytetarëve.

Neni 2

Përparësi në realizimin e projekteve të ndriçimeve publike do të kenë komunitetet që participojnë më përçindje më të lartë.

Neni 3

Rastet prioritare do të vlerësohen në gjashtë muajt e parë të vitit nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 4

Ndriçimi publik realizohet në ato lagje që kanë kryer (përmbushur) obligimet ndaj komunës.

Neni 5

Rrjeti i ndriçimit publik duhet të punohet në pajtim me normat teknike në fuqi, të përdoret material cilësor dhe pranimi teknik të bëhet nga Komisioni komunal.

Neni 6

Obligimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik dhe pagesat mujore të energjisë së shpenzuar i merr përsipër Komuna, gjegjësisht Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIE - OPSTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	334 / 12
Nr. i fq. / Br. sht	-1-
Data: / Datum	27.12.2012
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Bazuar në nenin 12 dhe 58 "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 /2008, nenin 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/1202 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nein 42.1, "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012, mori këtë:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i KK-së 01 Nr. 297/12, dt. 30.10.2012, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, si vijon: në paragrafin 1.1, nën-pika e 19-të, në vend të Bahri Bivolakut-zëdhënës i komunës duhet të jetë Avni Deliu-korrespondent i Radio Kosovës për Komunën e Vushtrrisë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Sekretaria e Kuvendit.


Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 ka shqyrtuar petitionin e banorëve të lagjeve: "Hakif Zejnullahu", "Haxhi Zeka", "Avni Rustemi", "Vëllezërit Frashëri", "Shemsi Ahmeti", "Shaban Kapuqi" dhe Ganimete Tërbeshi" në Vushtrri, kundër ndërtimeve të larta siç është theksuar në petition - në kundërshtim me rregullat urbanistike, standardet e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit si dhe ndalimin e ndërtimit në zonën në të cilën banojnë.

Pas një diskutimi të gjerë e të hollësishëm, si dhe bazuar në nenin 69 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenin 30 të Statutit të Komunës, në mbledhje e njëjtë, Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Refuzohet si i pa bazë peticioni i banorëve të lagjeve: "Hakif Zejnullahu", "Haxhi Zeka", "Avni Rustemi", "Vëllezërit Frashëri", "Shemsi Ahmeti", "Shaban Kapuqi" dhe Ganimete Tërbeshi" në Vushtrri, kundër ndërtimeve të larta siç është theksuar në petition - në kundërshtim me rregullat urbanistike, standardet e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit si dhe ndalimin e ndërtimit në zonën në të cilën banojnë.

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Neni 3

Me këtë vendim njoftohen organizatorët e petitionit: z. Bajram Musliu Rr. "Hakif Zejnullahu" Vushtrri, z. Isa Xhemajli Rr. "Avni Rustemi" Vushtrri, z. Besim Jashari Rr. "Avni Rustemi" Vushtrri (në emër të banorëve të bashkësisë së lagjeve)

Arsyetim

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 ka shqyrtuar petitionin e banorëve të lagjeve: "Hakif Zejnullahu", "Haxhi Zeka", "Avni Rustemi", "Vëllezërit Frashëri", "Shemsi Ahmeti", "Shaban Kapuqi" dhe Ganimete Tërbeshi" në Vushtrri, kundër ndërtimeve të larta siç është theksuar në petition - në kundërshtim me rregullat urbanistike, standardet e ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit si dhe ndalimin e ndërtimit në zonën në të cilën banojnë.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe në baza ligjore të të cekurave në petitionin në fjalë, me kërkesë të kryesuesit të mbledhjes, drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në mbledhjen e njëjtë ka sqaruar se në vendin në të cilin është duke u ndërtuar objekti shumëkatësh që i referohet peticioni, është i lejuar ndërtimi

shumëkatësh konform planit zhvillimor dhe urban të qytetit, të miratuar në muajin qershor të v. 2009, si dhe është në pajtim të plotë me standardet e ndërtimit, përkatësisht rregullativën tjetër ligjore në fuqi. Ai po ashtu ka informuar se investitori ka siguruar lejen ndërtimore për ndërtim të atij objekti. Andaj, bazuar në të cekurat më sipër, kuvendi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPSTINA VUCITRA

01 Nr. / Br 332/12

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data / Datum 27.12.2012

VUSHTRRI - VUCITRA



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fsh. Stanoc i Poshtëm kundër ndërtimit të shtëpisë publike – pushuese në zonën në të cilën banojnë.

Pas një diskutimi të gjerë e të hollësishëm nga anëtarët e KK-së, bazuar në shpjegimet profesionale të paraqitura nga drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit lidhur me peticionin, si dhe bazuar në nenin 69 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenin 30 të Statutit të Komunës, kuvendi në mbledhjen e njëjtë mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Kuvendi i Komunës konstaton se ndërtimi i atij objekti (pa prejjudikuar destinimin e ndërtimit) nuk është i lejuar për shkak se në atë zonë është i ndaluar ndërtimi i çfarëdo lloji të objekteve, për faktin se është tokë bujqësore dhe nën masën e komasacionit.

Neni 2

Në lidhshmëri me të cekurat në nenin paraprak, kuvendi i komunës kërkon nga Drejtoria për Inspektime në Vushtrri që të ndërmerri masa të menjëhershme ligjore për ndalim të ndërtimit të objektit të cilit i referohet peticioni.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Neni 4

Me këtë vendim njoftohen: Azem Rama, i nënshkruari i parë i peticionit si dhe Drejtori i Drejtorisë për Inspektime.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 ka shqyrtuar peticionin e banorëve të fsh. Stanoc i Poshtëm kundër ndërtimit të (siç është theksuar në peticion) shtëpisë publike – pushuese në zonën në të cilën banojnë. Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe në baza ligjore të të cekurave në peticionin në fjalë, me kërkesë të kryesuesit të mbledhjes, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në mbledhjen e njëjtë ka sqaruar se në vendin në të cilin ka filluar të ndërtohet objekti që i referohet peticioni, nuk është i lejuar ndërtimi pasi që ajo sipërfaqe është tokë bujqësore, përkatësisht nën masën e komasacionit.

Andaj, bazuar në të cekurat më sipër, kuvendi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa